



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 35-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.05.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Lulzim Rustemi
3. Naxhije Gashi
4. Arben Salihu
5. Slavisa Trajkovic
6. Zoran Çirković
7. Franjo Goleme

Të tjerë prezent

1. Zoran Stanojevic-ZLK
2. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
3. Merita Bytyqi, përkthyesë shqip-sherbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Emine Mustafa-Deliu**

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informatë nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale
3. Raporti i ZLK-s
4. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 34-të?

Naim Jahiri, është dashtë që në fillim të ceket që komiteti ka propozuar që Informata rreth shërbimeve publike të shtyhet për më vonë, pastaj pasi që ka ardh drejtori i shërbimeve publike prapë të rikthehet në mbledhje ajo pikë.

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 34-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës të ndryshme pasi që për momentin nuk e kemi prezent drejtoreshën e QPS-s

IV Të ndryshme

Lulzim Qerimi para se të fillojmë me pikën në vijim unë kam një propozim që takimin e ardhshëm ta mbajmë një takim në Janjevë të shkojmë të gjithë aty, kemi një qendër rinore dhe aty mundem ta mbajmë takimin.

Zoran Cirkovic, në mbledhjen e kaluar ka qenë prezent drejtori i shërbimeve publike Rasaim Hasani, ku ka diskutuar rreth punëve që janë duke u bërë dhe unë jam nda shumë i kënaqur për punët që janë bërë rreth rrugëve. Dhe është mirë që hera tjera kur të kanë ndonjë punë të konsultohen edhe me kryetarin e fshatit. Pasi që neve po na drejtohen dhe po na pyesin për punët që po kryhen dhe ne nuk po kemi informata.

Franjo Goleme, edhe unë pajtohem me Zoranin që për çka do që punohet të njoftohemi edhe na se kur po punon dikush nuk po dihet se çka po punohet dhe kush po e punon. Rruga te kisha në Janjevë nuk ka ndriçim publik.

Skender Bikliqi, ne si Bashkësi lokale nuk ju kemi përzier në punët e punë kryesve edhe pse ata nuk po e kryejnë punën si duhet dhe na po i vuajmë pasojat. Dhe po thuaj që çdo punë po e kryejnë nuk po i kryejnë si duhet. Edhe pse duhet të ketë bashkëpunim më të mirë në mes të Komunës, punë kryesve dhe Bashkësisë lokale.

Lulzim Qerimi, tha se drejtorati për Shërbime publike është duke i zhvilluar 20-30 projekte në teren dhe deri me tani ne nuk kemi asnjë ankesë. Por është mirë që kryetari i fshatit të bisedoj me menaxherin nese nuk mundem me kryer pune me menaxherin, takohet me drejtorin neve nënkryetareve apo edhe kryetarin.

Zoran Cirkovic, unë e kam falënderuar drejtorin Rasimin, për punët që janë duke u zhvilluar, por asnjë projekt nuk është mirë me kaluar pa u konsultua edhe me këshillin e fshatit ose kryetarin e fshatit dhe asnjë projekt të mos kaloj pa bashkëpunimin me kryetarin e fshatit.

Franjo Goleme, po lidhem me parafolësit i njëjti problem është edhe në Janjevë ku një rrugë që 8 vite është e prishur dhe askush nuk u intersuar për atë rrugë, ne pyesim se kush janë njerëzit kompetent.

Lulzim Rustemi, kompania nuk merrë obligim me kontaktuar me qytetarë, por është menaxheri i kontratës ai të cilit duhet të drejtoheni. Dhe asnjë projekt nuk ka pa menaxher dhe ju i drejtoheni menaxherit dhe bashkë me komunën e zgjidhni problemin.

Lulzim Qerimi,unë jam për me pas bashkëpunim në mes të Komunës dhe qytetarëve dhe ju kërkoj të gjitha komuniteteve që për çdo problem na kontaktoni qoftë mua apo edhe kryetarin.

Skender Bikliqi, herat tjera ne do të vijmë për çdo problem që kemi ne teren në zyrën e nënkryetarit por edhe të drejtorëve.

Arben Salihu,në pjesën ku banoj unë, rruga edhe pse figuron si rrugë,ajo në fletë poseduese është pronë private. Si është e mundur?

II

Informatë nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale mbi gjendjen sociale të komuniteteve

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi,ia kaloj fjalën Makfirete Shamolli, drejtoreshë në QPS, e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Informatës nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale mbi gjendjen sociale të komuniteteve.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Naim Jahiri, a kemi rritje të numrit të personave që do të marrin asistencë sociale, për shkak të pandemisë që e kanë humbur punën a keni numër të saktë.

Makfirete Shamolli,numri i kërkesave është rritur për arsye të situatës që po përballemi me pandemi. Dhe ne si Lipjan kemi numër të madh të familjeve që marrin asistencë sociale.

Lulzim Rrustemi,unë i kam disa pyetje,a ka prej komuniteteve që bëjnë kërkesa për asistencë sociale. A dilni me i vizituar në teren ata që vijnë me kërkesa për ndihmë sociale për me i pa gjendjen që e kanë. Dhe a ka nevojë me u ndryshuar ligji që me pas mundësi ma tepër për persona me asistencë sociale.

Makfirete Shamolli, ne rastet i vizitojmë në teren dhe ka shumë indikator që ndikon te qytetarët. Ne e shqyrtojmë çdo kërkesë të qytetarëve. Ndërsa sa i përket ligjit nuk ka kalu ende se di pse edhe pse është një ligj shumë i mirë.

Zoran Cirkovic,jemi falënderues për punën që po e bëni, a do të ketë ndihma përsëri dhe a do të përsëriten riaplikimi për ndihma.

Makfirete Shamolli, pjesa e pakove emergjente do të vazhdon ne do t'i inkurajojmë donatorë për me na ndihmu por ne jemi duke mendu me bo një radhitje dhe me i përfshi të gjithë ata që kanë nevojë .

Riaplikimi pritet në qershor pasi që menaxhohet nga qeveria.

Lulzim Qerimi,ju falënderoj për angazhimin që jeni duke e bërë në teren,në veçanti në emër të komitetit ju falënderoj.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi,ia kaloj fjalën Zoran Stanojevic nga ZLK e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZLK-së

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Zoran Cirkovic, jam i kënaqur me reportin e ZLK-s, që po na informon çdo mbledhje, Kam një pyetje për konkurset për vendet e lira të punës, të personave që janë pensionuar a do të ketë.

Zoran Sanojevic, nuk ka asnjë konkurs njëherë se nuk po i lejon ministria dhe si duket nuk do të ketë deri në fund të vitit

Lulzim Rrustemi, a ka ndonjë informatë rreth shtëpisë së djegur në fshatin Grackë për ndërtim?

Zoran Cirkovic, një pako ushqimore ju ka dërguar ,ndërsa rreth ndërtimit do të bisedohet me noterin, ne e kemi marrë përsipër.

Lulzim Qerimi, projekt nga IOM a ju lejohet familjeve të riatdhesuara apo të gjithë qytetarët.

Zoran Stanojevic, prej 10 kandidatëve do të përzgjedhin vetëm dy.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14³⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi